



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1362/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.N. “L....“ sh.a me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Ekrem Agushi me seli në Prishtinë, kundër debitorit: N.N.T. “B....”” - Lagja Rr. Shkupit me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.127/2021 të datës 03.08.2021 të Përmbartuesja Myjesere Mujku me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.N.T. “L....”” - Lagja Rr. Shkupit me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.127/2021 të datës 03.08.2021 të Përmbartuesit Privat Myjesere Mujku.

II.MBETET në fuqi Urdhri P.nr.127/2021 i datës 03.08.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku.

A r s y e t i m

Përmbaresja Private Myjesere Mujku, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, N.N. “L....”, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati Ekrem Agushi nga Prishtina, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Ekonomike V.EK.nr.86/16 i datës 08.12.2020 ka lejuar urdhrin P.nr.127/2022 me datën 30.08.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit, ndaj debitorit N.N.T. “L....”” - Lagja Rr. Shkupit me seli në Prishtinë me të cilën është detyruar debitori që t’ia paguajnë kreditorit në afatin prej 15 ditëve borxhin në shumën prej 3,718.00 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori kishte parashtruar prapsim në afatin e parapari ligjor me të cilin kishte kërkuar që përbarimi mos të kryhet tani për tani meqenëse pala debitore ka kishte paraqitur revizion kundër aktgjyqimit të lartpërmendur. Tutja kishte shtuar se pretendimet e paraqitura në revizion janë bazë e mjaftueshme që Aktgjykimi në fjalë të kthehet në rivlerësim dhe rigjykim, prandaj pala debitore bazuar në këto pretendime kërkon që përbarimi të ndërpritet sepse arsyet për aprovim pritet të jenë të bazuara.

I kishte propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi i debitorit dhe të pezullohet apo të ndërpritet urdhri i propozuar për përbarim P.nr.127/2021 të datës 30.08.2021 si dhe të pezullohen të gjitha veprimet e ndërmarra ndaj debitorit të përbarimit.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe se të njëjtat janë të pabazuara, duke shtuar se qëllimi i debitorit të përbarimit është vetëm zvarritja e procedurës përbarimore, po ashtu i njëjti kishte theksuar se lidhur me pretendimet e debitorit që ishte thirrur se procedura në këtë çështje ende nuk ka përfunduar, këto pretendime për kreditorin e përbarimit janë të pa themelta ngase revizioni i paraqitur nuk e shtynë ekzekutimin e përbarimit të aktgjyqimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshme. I kishte propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përbarimore në shumën prej 156 euro për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, (tutje LPP-së) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë asnjëra nga shkaqet të cilat parashihen me nenin 69 të LPP-së me të cilat prapësimi i debitorit të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbaremore, ndërsa gjykata duke u mbështetur në shkresat e lëndës ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbareuesit Privat P.nr. P.nr.127/2021 të datës 30.08.2021, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbareues (titullit ekzekutiv) – aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike V.Ek.nr.86/2016, datë 08.12.2020, aktgjykim i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 07.06.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 29.06.2021.

Sipas dokumentit përmbareues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.86/2016 debitori ishte detyruar që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbaremore shumë prej 3.718.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 156.00 euro, nën kërcenim të përmbaremit me detyrim.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbaremore – aktgjykimi i lartcekur është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbaremore duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaremore në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaremore origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbaremore, kërkuesi i përmbaremit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbaremore, objekti i përmbaremit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbaremit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremoren vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të*

besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbarese siç janë: “vendimi përmbare i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbare;”, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se “ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbareshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përmbare është i përshtatshëm për përmbare në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbare i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu trajtuar si dokument përmbare dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbaremit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Ekonomike V.Ek.nr. 86/2020 i datës 08.12.2020 është i përmbareshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbare, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitorët, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbare, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 par.4 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 156.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbare, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për

lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 39, 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1362/22 dt. 30.11.2022

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes kësaj Dhome.